EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6606
E martë, 16 maj 2022
çmimi 0.40 €

Opozita: Projektligji për mjetet e Trustit, sa më shpejt në Kuvend

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË PËRURUAR LIBRI I BARDHYL MAHMUTIT "ESKADRONËT E VDEKJES (KRONIKË E NJË KASAPHANE)" FAQE 4-5

BARDHYL MAHMUTI SJELL DËSHMI TË REJA PËR GJENOCIDIN E SERBISË NË KOSOVË

Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës në Prishtinë është përuruar të hënën romani dokumentar i Bardhyl Mahmutit "Eskadronët e vdekjes (Kronikë e një kasaphane)". Gjenocidi serb i kryer në Kosovë po tregohet tashmë edhe përmes këtij libri, të cilin e ka botuar Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur". Në përurimin e këtij libri kanë marrë pjesë personalitete nga jeta akademike, politike, veprimtarë të shumtë dhe ish-të burgosur politikë. Libri "Eskadronët e vdekjes" është provë e hollësishme dhe e drejtpërdrejtë e krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe ndaj intelektualëve serbë që e ngritën zërin kundër gjenocidit në Kosovë. Ky libër është vlerësuar lart nga Agim Vinca, Majlinda Sinani-Lulaj, Adem Gashi dhe Adnan Asllani

Në 23-vjetorin e zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti, kërkohet zbardhja e fatit të tij

FAQE 3

QEVERIA E KOSOVËS SHTON SANKSIONET KUNDËR RUSISË

FAQE 5

AKTUALE

SUEDIA DO TË APLIKOJË PËR ANËTARËSIM NË NATO F. 2

THEKSOHET NEVOJA PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE ME PROKURORË TË RINJ F. 7

RAPORTIME KËRCËNUESE PËR BOMBA NË URAT E BEOGRADIT F. 6

EKONOMI

PROGRAMI ACCESS LEHTËSON TRANSFORMIMIN DIGJITAL NË SEKTORIN PRIVAT DHE PUBLIK NË KOSOVË F. 8

KEDS-i FILLOI PROGRAMIN "VAJZAT NË TEKNOLOGJI - GIRLS TECH" F. 8

SPORT

MINISTRI ÇEKU: PUNIMET NË STADIUMIN 'ADEM JASHARI' DHE ATË TË GJILANIT I KEMI VËNË NË PRIORITET F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Norvegjia, Danimarka dhe Islanda zotohen ta mbrojnë Finlandën e Suedinë në rast sulmi

Oslo, 16 maj - Norvegjia, Danimarka dhe Islanda janë zotuar që ta mbrojnë Finlandën e Suedinë nëse rast se këto dy shtete do të ekspozohen ndaj ndonjë sulmi në territorin e tyre.
Kryeministri i Norvegjisë, Jonas Gahr Stoere, është shprehur se shteti i tij është i gatshëm t'i mbrojë fqinjët nordikë. "Bashkë me Danimarkën dhe Islandën, Norvegjia qëndron në gatishmëri për t'i ndihmuar fqinjët nordikë me të gjitha mjetet e nevojshme nëse do të bëhen viktima të ndonjë agresioni në territorin e tyre derisa ta sigurojnë anëtarësimin në NATO", ka thënë ai.
Kujtojmë se kryeministrja e Suedisë, Magdalena Andersson, ka njoftuar se vendi i saj do t'i bashkohet Finlandës dhe do të kërkojnë anëtarësim në NATO në një kohë që Ukraina është e pushtuar nga Rusia. Nga tetë partitë e Suedisë, vetëm dy parti të vogla të majta kanë dalë kundër anëtarësimit të Suedisë.

Suedia do të aplikojë për anëtarësim në NATO

Stokholm, 16 maj - Suedia i është bashkuar Finlandës në vendimin për të aplikuar për anëtarësim në aleancën ushtarake të NATO-s teksa pushtimi i paprovokuar rus i Ukrainës po vazhdon. Ky njoftim nga Stokholmi vjen teksa presidenti rus, Vladimir Putin, ka thënë se Moska "sigurisht" që do të reagojë për një zgjerim të mundshëm të NATO-s. "Qeveria ka vendosur për ta njoftuar NATO-n se Suedia dëshiron të bëhet anëtare e NATO-s. Ambasadori i Suedisë në NATO shumë shpejt do ta informojë NATO-n", ka thënë kryeministrja suedeze, Magdalena Andersson.
Njoftimi i Suedisë vjen një ditë pas shteti tjetër nordik, Finlanda, që ndan një kufi prej 1 300 kilometrash me Rusinë, ka bërë njoftim të ngjashëm. Finlanda, sikurse Suedia, janë shtete neutrale. Finlanda kishte humbur afër 10 për qind të territorit të saj në Bashkimin Sovjetik. Pavarësisht se janë shtete neutrale, si Finlanda ashtu edhe Suedia kanë bërë lëvizje të shpejta për t'u anëtarësuar në aleancën ushtarake teksa janë rritur shqetësimet për shkak të agresionit ushtarak të Rusisë.

Presidenti i Finlandës, Sauli Niinisto dhe kryeministrja finlandeze, Sanna Marin, kanë thënë se pas konsultimit me parlamentin, shteti mëton që shumë shpejt të aplikojë për anëtarësim në NATO.
Në Moskë, presidenti rus, Vladimir Putin, ka thënë të hënën se përderisa Rusia nuk e sheh si kërcënim vendimin e Finlandës dhe Suedisë për t'u bashkuar në NATO, dislokimi i infrastrukturës ushtarake në këto dy shtete do të prodhonte përgjigje nga Moska. Zgjerimi i NATO-s me Suedinë dhe Finlandën nuk "paraqet kërcënim direkt për ne…, por zgjerimi i infrastrukturës ushtarake në këto territore sigurisht se do ta provokojë përgjigjen tonë", ka thënë Putini gjatë një samiti të Organizatës së Traktatit për Siguri Kolektive (CSTO), aleancë ushtarake që udhëhiqet nga Moska. Më herët, gjatë 16 majit, zëvendësministri i Mbrojtjes i Rusisë, Sergei Ryabkov, ka thënë se anëtarësimi i Finlandës dhe Suedisë në NATO do të ishte "një gabim i rëndë me pasoja të mëdha".

Ministrat e BE-së i bëjnë thirrje Hungarisë ta mbështesë embargon ndaj naftës ruse

Bruksel, 16 maj - Ministrat e Jashtëm të Bashkimit Evropian (BE) kanë kërkuar të hënën nga Hungaria që ta heqë veton për embargon e propozuar ndaj naftës ruse, teksa Lituania ka bërë me dije se blloku po "mbahet peng nga një shtet anëtar".
Embargoja ndaj importeve të naftës së papërpunuar ruse është propozuar nga Komisioni Evropian më herët gjatë majit dhe, nëse miratohet, do të ishte sanksioni më i ashpër në përgjigje të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia. Gjermania, që është blerësja më e madhe e energjisë ruse, ka thënë se dëshiron një marrëveshje që autorizon embargon e naftës që, sipas këtij shteti, mund të zgjaste për vite të tëra. "Jam e bindur se do të gjejmë një marrëveshje në ditët në vijim", ka thënë ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, teksa ka arritur në takimin me homologët e saj.
Por, Hungaria, që është aleatja kryesore e Rusisë në BE, ka thënë se dëshiron qindra-milionë dollarë nga blloku për ta mbuluar koston e heqjes dorë nga nafta e papërpunuar ruse. Që propozimi i Komisionit Evropian të hyjnë në fuqi, duhet që të pajtohen të 27 shtetet e BE-së. "I gjithë blloku po mbahet peng nga një shtet anëtar. Ne duhet të pajtohemi, ne nuk mund të mbahemi peng", ka thënë ministri i Jashtëm i Lituanisë, Gabrielius Landsbergis. Edhe ministra të tjerë të jashtëm të bllokut i bën thirrje Hungarisë që të pajtohet për embargon ndaj naftës ruse.

Britania: Bjellorusia po vendos forca speciale në kufi me Ukrainën

Londër, 16 maj - Ministria e Mbrojtjes e Britanisë ka raportuar për rritje të aktivitetit të forcave të armatosura të Bjellorusisë. Kjo tregon se është pjesë e taktikës për ta shpërqendruar pozicionimin e trupave ushtarake ukrainase.
Mediet e huaja kanë shkruar se, pavarësisht prej spekulimeve, forcat bjelloruse nuk ishin përfshirë drejtpërdrejt në konflikt. "Aleksandër Lukashenko kërkon ta demonstrojë mbështetjen ndaj Vladimir Putinit, por nuk dëshiron as të përfshihet në luftë apo të përballet me sanksionet e rënda të Perëndimit", shkruajnë mediet e huaja.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Në 23-vjetorin e zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti, kërkohet zbardhja e fatit të tij

Njëzet e tre vjet më parë ishte hera e fundit që u pa i gjallë veprimtari, intelektuali dhe mendimtari i guximshëm nga Krusha e Madhe, Ukshin Hoti. Më 16 maj të vitit 1999 (e diel), Ukshin Hoti ishte nxjerrë nga burgu i Dubravës, me pretekstin se po lirohej. Në fakt, ky kishte qenë rrëmbimi i tij nga burgu drejt një destinacioni të panjohur edhe sot. Përfaqësues të pushtetit qendror dhe lokal kanë theksuar se ndriçimi i fatit të profesorit Ukshin Hoti është detyrë kombëtare

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 16 maj - Njëzet e tre vjet më parë ishte hera e fundit që u pa i gjallë veprimtari, intelektuali dhe mendimtari i guximshëm nga Krusha e Madhe, Ukshin Hoti. Ai i përket profilit më të lartë të dijetarëve shqiptarë, i cili tërë intelektin, dijen dhe trupin e tij ia fali çështjes shqiptare. Më 16 maj të vitit 1999 (e diel), Ukshin Hoti ishte nxjerrë nga burgu i Dubravës, me pretekstin se po lirohej. Në fakt, ky kishte qenë rrëmbimi i tij nga burgu drejt një destinacioni të panjohur edhe sot.

Me rastin e 23-vjetorit të zhdukjes së veprimtarit të çështjes kombëtare, Ukshin Hoti, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka bërë homazhe pranë bustit të tij, në oborrin e shtëpisë-muze në fshatin Krushë e Madhe. Gjatë vizitës kreu i Kuvendit u prit nga Andin Hoti, i biri i veprimtarit Ukshin Hoti. Me këtë rast Konjufca ka thënë se 23 vjet më parë në Kosovë është kryer një krim i madh nga shteti serb, të cilin e ka përjetuar rëndë i gjithë kombi. Sipas tij, Ukshin Hoti ka lënë pas një trashëgimi të madhe dhe të gjatë për ta kujtuar. "Ai na ka lënë një trashëgimi të jashtëzakonshme intelektuale, patriotike dhe atdhetare, të cilën gjithnjë do ta kujtojmë brezat e tashëm dhe të ardhshëm, për shkak të mendimeve politike që na i ka lënë. Vepra e tij na ndriçon rrugën edhe sot, edhe si zyrtarë politikë, por edhe atyre që studiojnë politikën", ka thënë Konjufca.

Për zhdukjen e Ukshin Hotit 23 vjet më parë, sipas kryetarit Konjufca, shteti serb ende nuk ka dhënë përgjegjësi dhe askush nuk është dënuar, edhe pse dihen autoritetet e burgut të Dubravës në kohën kur ishte zhdukur ai.

Kjo qasje e Serbisë, shtoi kryetari Konjufca, dëshmon se shteti serb nuk ka ndryshuar mendim që nga koha e vitit 1998. "Kjo qasje tregon se Serbia nuk ka ndërruar drejtimin të cilin e ka pasur në vitet 1998-1999 kundër popullit shqiptar. Ukshin Hoti do të kujtohet gjithnjë sa të ketë komb shqiptar për arsye se veprimtaria e tij patriotike ka vazhduar dekada me radhë. Ai ishte i gatshëm ta lë edhe postin e profesorit në Universitetin e Prishtinës për t'u dalë në mbrojtje protestave të studentëve të vitit 1981. Me këtë ka dëshmuar se ishte gjithnjë në anën e popullit", ka thënë Konjufca.

Edhe presidentja Vjosa Osmani e ka përkujtuar intelektualin Ukshin Hoti në 23-vjetorin e zhdukjes. "Janë 23 vjet pritjeje e ankthi për njeriun që mendimin politik e sinkronizoi me aktivizmin politik për lirinë, republikën dhe demokracinë. Republika, liria dhe demokracia u bënë, porse fati i mendimtarit mbetet ende peng. Ai i qëndroi besnik idesë së republikës, e liria do të ketë kuptim vetëm kur fati i tij dhe i të zhdukurve me dhunë të tjerë, të zbardhet krahas me vendosjen e drejtësisë", thuhet në përkujtimin e presidentes Osmani.

Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka përkujtuar profesorin e veprimtarin e shquar të çështjes kombëtare, Ukshin Hoti, në 23-vjetorin e zhdukjes së tij.

Krasniqi në "Facebook" ka shkruar se Ukshin Hoti ishte intelektual i pazëvendësueshëm që, me zë, shkrime e vepra artikuloi idenë dhe punoi pareshtur për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës, si dhe ka kërkuar zbardhjen e fatit të tij. "Me guximin e tij politik, Ukshin Hoti frymëzoi shumë breza intelektualësh e patriotësh shqiptarë. Fatkeqësisht, për më shumë se dy dekada i njëjti regjim që zhduki në errësirën e krimeve të tyre edhe profesorin Ukshin, sot, me një tjetër fytyrë, po e mban të fshehur të vërtetën e këtij rasti. Për zbardhjen e fatit të profesorit Ukshin dhe të qindra qytetarëve të tjerë të Kosovës që figurojnë ende të zhdukur, populli dhe shteti ynë nuk do të ndalet asnjëherë së kërkuari informata, drejtësi dhe, mbi të gjitha, përgjegjësi", ka shkruar Krasniqi.

Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se Ukshin Hoti nuk ishte vetëm profesor, ai ishte një intelektual jokonformist që rebelohej pa menduar për pasojat ndaj padrejtësive. "Braktisi pozitat dhe shkoi në burg, nga Universiteti i Harvardit u kthye në Krushë të Madhe, në kohën kur nevoja për njerëz si ai ishte më e madhe se asnjëherë më parë. Mendja brilante e Ukshin Hotit ishte bërë kërcënim për pushtuesin shtypës, që donte zhbërjen e kombit shqiptar në Kosovë. Prandaj, jo rastësisht, ai u shënjua si armik i sistemit", ka thënë Latifi, duke shtuar se ndriçimi i fatit të profesor Ukshin Hotit është detyrë kombëtare. "Trashëgimia e tij intelektuale, e lënë në librat e teoritë e tij të shkruara, është shtegu që duhet ndjekur kombi ynë drejt civilizimit e përparimit mbarëkombëtar", ka thënë kryetari Latifi.

Veprimtari dhe intelektuali Ukshin Hoti figuron i zhdukur që nga 16 maji i vitit 1999, ditën kur kishte për t'u liruar nga burgu i Dubravës.

Haradinaj ia dorëzon djalit të Ukshin Hotit medaljen "Me besim në zot, atdhe e shtet"

Në nderim të veprës jetësore të Ukshin Hotit, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, Andin Hotit, djalit të Ukshinit, ia ka dorëzuar medaljen "Me besim në zot, atdhe e shtet". "Të përulur me respekt, në shtëpinë muze të Ukshin Hotit, kujtojmë intelektualin, kryengritësin, rrezatuesin mbi injorancën dhe zërin moral të shoqërisë shqiptare. Ukshin Hoti formësoi mendimin politik shqiptar, promovoi etikën në politikë dhe mbetet shembull për elitat politike të shqiptarëve. Në nderim të veprës së tij jetësore, sot i kam ndarë medaljen 'Me besim në zot, atdhe e shtet'", ka bërë me dije Haradinaj.

ËSHTË PËRURUAR LIBRI I BARDHYL MAHMUTIT "ESKADRONËT E VDEKJES (KRONIKË E NJË KASAPHANE)"

Bardhyl Mahmuti sjell dëshmi të reja për gjenocidin e Serbisë në Kosovë

Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës në Prishtinë është përuruar të hënën romani dokumentar i Bardhyl Mahmutit "Eskadronët e vdekjes (Kronikë e një kasaphane)". Gjenocidi serb i kryer në Kosovë po tregohet tashmë edhe përmes këtij libri, të cilin e ka botuar Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur". Në përurimin e këtij libri kanë marrë pjesë personalitete nga jeta akademike, politike, veprimtarë të shumtë dhe ish-të burgosur politikë. Libri "Eskadronët e vdekjes" është provë e hollësishme dhe e drejtpërdrejtë e krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe ndaj intelektualëve serbë që e ngritën zërin kundër gjenocidit në Kosovë. Ky libër është vlerësuar lart nga Agim Vinca, Majlinda Sinani-Lulaj, Adem Gashi dhe Adnan Asllani

Mal QORRAJ

Prishtinë, 16 maj - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës në Prishtinë është përuruar të hënën libri i Bardhyl Mahmutit "Eskadronët e vdekjes (Kronikë e një kasaphane)". Në këtë përurim kanë marrë pjesë personalitete nga jeta akademike, politike, veprimtarë të shumtë dhe ish-të burgosur politikë.

Ky libër ka nëntë kapituj.

Në këtë libër nuk flet autori, por personazhi. Ky libër ka plot rrëfime të ndryshme për gjenocidin serb në Kosovë.

Libri "Eskadronët e vdekjes" është provë e hollësishme dhe e drejtpërdrejtë e krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe ndaj intelektualëve serbë që e ngritën zërin kundër gjenocidit në Kosovë.

Libri i Bardhyl Mahmutit "Eskadronët e vdekjes" është vlerësuar lart nga folësit e librit: Agim Vinca, Majlinda Sinani-Lulaj, Adem Gashi dhe Adnan Asllani.

Në përurimin e këtij libri, autori i librit, Bardhyl Mahmuti, nuk i fshehu emocionet derisa i përmendi ish-luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët po akuzohen nga Gjykata Speciale në Hagë. "Është e njohur ajo sintagma se fjalët nuk janë neutrale, por në rrafshin politik, nëse do të kishim pasur kapacitet t'i shtrydhnim në Kosovë, fjalët do të kullonin gjak, fjalët do të kullonin lot, fjalët do të kullonin mund. Dhe ky mund, këta lot, ky gjak sot e kësaj dite nuk na lë të qetë. Jakup Krasniqi, një ndër njerëzit më të ndershëm që ka Kosova, sot është në Hagë. Janë përmbysur gjërat për 23 vjet. Në vend që Serbia të përgjigjet për gjenocid, shokët tanë janë në Hagë, lufta jonë është vënë në bankë të akuzës. Unë aq sa kam mundur kam nxjerr nga vetja një të vërtetë, falë jush", ka thënë autori.

→

ËSHTË PËRURUAR LIBRI I BARDHYL MAHMUTIT "ESKADRONËT E VDEKJES (KRONIKË E NJË KASAPHANE)"

Bardhyl Mahmuti sjell dëshmi të reja për gjenocidin e Serbisë në Kosovë

Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës në Prishtinë është përuruar të hënën romani dokumentar i Bardhyl Mahmutit "Eskadronët e vdekjes (Kronikë e një kasaphane)". Gjenocidi serb i kryer në Kosovë po tregohet tashmë edhe përmes këtij libri, të cilin e ka botuar Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur". Në përurimin e këtij libri kanë marrë pjesë personalitete nga jeta akademike, politike, veprimtarë të shumtë dhe ish-të burgosur politikë. Libri "Eskadronët e vdekjes" është provë e hollësishme dhe e drejtpërdrejtë e krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe ndaj intelektualëve serbë që e ngritën zërin kundër gjenocidit në Kosovë. Ky libër është vlerësuar lart nga Agim Vinca, Majlinda Sinani-Lulaj, Adem Gashi dhe Adnan Asllani

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

Prishtinë, 16 maj - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës në Prishtinë është përuruar të hënën libri i Bardhyl Mahmutit "Eskadronët e vdekjes (Kronikë e një kasaphane)". Në këtë përurim kanë marrë pjesë personalitete nga jeta akademike, politike, veprimtarë të shumtë dhe ish-të burgosur politikë.

Ky libër ka nëntë kapituj.

Në këtë libër nuk flet autori, por personazhi. Ky libër ka plot rrëfime të ndryshme për gjenocidin serb në Kosovë.

Libri "Eskadronët e vdekjes" është provë e hollësishme dhe e drejtpërdrejtë e krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe ndaj intelektualëve serbë që e ngritën zërin kundër gjenocidit në Kosovë.

Libri i Bardhyl Mahmutit "Eskadronët e vdekjes" është vlerësuar lart nga folësit e librit: Agim Vinca, Majlinda Sinani-Lulaj, Adem Gashi dhe Adnan Asllani.

Në përurimin e këtij libri, autori i librit, Bardhyl Mahmuti, nuk i fshehu emocionet derisa i përmendi ish-luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët po akuzohen nga Gjykata Speciale në Hagë. "Është e njohur ajo sintagma se fjalët nuk janë neutrale, por në rrafshin politik, nëse do të kishim pasur kapacitet t'i shtrydhnim në Kosovë, fjalët do të kullonin gjak, fjalët do të kullonin lot, fjalët do të kullonin mund. Dhe ky mund, këta lot, ky gjak sot e kësaj dite nuk na lë të qetë. Jakup Krasniqi, një ndër njerëzit më të ndershëm që ka Kosova, sot është në Hagë. Janë përmbysur gjërat për 23 vjet. Në vend që Serbia të përgjigjet për gjenocid, shokët tanë janë në Hagë, lufta jonë është vënë në bankë të akuzës. Unë aq sa kam mundur kam nxjerr nga vetja një të vërtetë, falë jush", ka thënë autori.

→

Qeveria e Kosovës shton sanksionet kundër Rusisë

Qeveria e Kosovës ka shtuar të hënën sanksionet kundër Rusisë në përputhje me sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara (ShBA) dhe Bashkimin Evropian (BE). Sanksionet e Kosovës nënkuptojnë ngrirje të aseteve të të sanksionuarve në territorin e Kosovës, ndalim të operimit në tregun financiar të Kosovës, ndalim-udhëtimi, si dhe bllokim të qasjes në fonde për të sanksionuarit

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 MAJ - Qeveria e Kosovës ka shtuar të hënën sanksionet kundër Rusisë në përputhje me sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian, prej kur Moska ka nisur sulmin e paprovokuar në Ukrainë më 24 shkurt.

Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, Kreshnik Ahmeti, ka thënë në mbledhjen e Qeverisë se Kosova është rreshtuar krah politikave të ShBA-së dhe BE-së për sanksionet. Në pakon e sanksioneve përfshihen ndalesa edhe për Bjellorusinë.

Sanksionet e Kosovës nënkuptojnë ngrirje të aseteve të të sanksionuarve në territorin e Kosovës, ndalim të operimit në tregun financiar kosovar, ndalim udhëtimi si dhe bllokim të qasjes në fonde për të sanksionuarit.

Përveç këtyre sanksioneve, Qeveria e Kosovës është pajtuar edhe për vendosjen e masave kufizuese për grupin Wagner, i cili përbëhet nga mercenarë me bazë në Rusi. "Individët e listuar nga BE-ja janë të përfshirë në abuzime serioze në të drejtat e njeriut, duke përfshirë torturat dhe ekzekutimet jashtëgjyqësore", ka thënë Ahmeti, duke iu referuar individëve të lidhur me grupin Wagner, që janë sanksionuar nga blloku evropian.

Kremlini pretendon se Wagneri është grup privat, mirëpo ai konsiderohet i afërt me presidentin rus Vladimir Putin.

Mercenarët e këtij grupi dyshohen për abuzime në Mali, Libi dhe Siri.

"Pas shqyrtimit është miratuar në mbledhje ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të qeverisë nr. 01/64, i datës 25 shkurt 2022, i amandamentuar me vendimin nr. 13/68, të datës 23 mars 2022, për 'zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë'. Sipas vendimit, sanksionet do të konsistojnë në ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara; ndalimin e qasjes dhe operimit në tregun financiar në Kosovë individëve apo entiteteve të sanksionuara; ndalimin e udhëtimit në territorin e Republikës së Kosovës të individëve të sanksionuar; ndalimin për individë dhe entitete të Republikës së Kosovës që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte për individët dhe entitetet e sanksionuara; ndalimin për çdo ndërmarrje transporti rrugor rus apo bjellorus që të transportojnë mallra në Republikën e Kosovës (përjashtimisht të produkteve farmaceutike, mjekësore, bujqësore dhe ushqimore për qëllime humanitare); ndalimin e importit nga Rusia të qymyrit dhe lëndëve të tjera djegëse të ngurta fosile në Kosovë, nëse ato janë me origjinë nga Rusia ose eksportohen nga Rusia", është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Kosova dhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, përveç Serbisë, kanë përkrahur sanksionet e Perëndimit kundër Rusisë.

Ministrat e Jashtëm të Bashkimit Evropian do të diskutojnë më 16 maj për raportet e bllokut evropian me Ballkanin Perëndimor. Më vonë, gjatë ditës së hënë, ata do të kenë edhe një takim të përbashkët me shefat e diplomacisë së gjashtë vendeve të këtij rajoni.

"Diskutimet për Ballkanin Perëndimor, në takimin e 27 ministrave, sikur edhe ato kur të takohen së bashku ministrat e BE-së me ata të vendeve të rajonit, do të jetë përballja e përbashkët me sfidat dhe pasojat që ka krijuar agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës".

→

E studiuesi Agim Vinca ka thënë se ky libër duhet të përkthehet edhe në gjuhën serbe dhe kroate. Ai ka thënë se autori Bardhyl Mahmuti e ka ndjekur parimin e së vërtetës, ndërkohë që ka rrëfyer se librin fillimisht e kishte lexuar në verën e vitit të kaluar gjatë një pushimi në Strugë. "Pasi e lexova librin e Bardhylit, siç thashë në pushimin në Strugë, me të kthyer në Prishtinë i bëra një mesazh të cilin po e lexoj këtu: I dashur Bardhyl, e lexova librin nga faqja e parë deri tek e fundit, e ke zhveshur deri në palcë krimin serb mbi Kosovën dhe shqiptarët, por edhe monstruozitetin e një regjimi kriminal që nuk e kursen as popullin e vet që vret e masakron kundërshtarët e tij politikë edhe nga radhët e popullit të vet. Je njohës i shkëlqyer i mjediseve, rrethanave dhe mendësisë serbe dhe e ke gjetur mënyrën si ta paraqesësh atë, duke ia dhënë fjalën një gazetari profesionist dhe humanist serb nga qyteti i Kraljevës", ka thënë Vinca.

Në përurimin e librit shkrimtari Adem Gashi ka thënë se Bardhyl Mahmuti e përshkruan në mënyrë tejet të veçantë karakterin e personazhit të librit. "Në aspektin rrëfimor Bardhyli më habitë me rrjedhshmëri e spontanitet, me kulturë, me gjetje të figurshme në krahasime nga më të rrallat. Ai zotëron fenomenin që ne e quajmë fytyrëzim gjuhe, nga grimasa e deri te semantika e shqiptimit të fjalëve e zbulojmë karakterin e personazhit", ka thënë ai.

Ndërsa publicistja Majlindë Sinani-Lulaj ka thënë se libri "Eskadronët e vdekjes" ka një logjikë teksti që nuk të humbet, por të mban me këmbë në tokë. "E tronditë lexuesin, por jo deri aty sa ta braktisë leximin. E ngarkon me anën emocionale, po jo sa për ta humbur arsyen. Qartëson anët, ndan rrugët, nuancon dhimbjet, por racionalisht krijon baraspeshën rrëfyese dhe ndërton konvergjencën kontekstuale të tragjikes. Kjo gjë, mendoj unë, i krijon librit veshjen e duhur për të hyrë dhe përmbushur misionin, holleve e salloneve (edhe mondane), ku ndonjëherë politika dhe diplomacia jonë nuk kanë një vend, apo në raste kur e kanë, harrojnë pse janë aty", ka thënë Sinani-Lulaj.

Libri "Eskadronët e vdekjes" është botuar nga Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur".

Adnan Asllani ka thënë se ky takim i sotëm, përpos që ka vlera artistike, bartë me vete edhe misionin për publikimin e të vërtetës. "Ajo çka ka ndodhur gjatë luftës në Kosovë është plaga jonë e hapur të cilën shteti serb, i cili asnjëherë nuk është distancuar nga e kaluara e tij, vazhdon ta ngacmojë. Shteti serb, sipas traditës së dy shekujve të fundit, së paku, sa herë i është dhënë mundësia ka bërë gjenocid ndaj shqiptarëve. Kështu ka ndodhur pas vitit 1878, kështu ka ndodhur gjatë Luftës së Parë Botërore, kështu ka ndodhur gjatë luftërave ballkanike, gjatë e pas Luftës së Dytë Botërore e kështu ndodhi edhe me luftën e fundit në Kosovë", ka thënë ai, duke shtuar se krimi i gjenocidit në Kosovë ka mbetur i pandëshkuar andaj, sipas tij, kjo është një plagë e hapur për ne. "20 vjet pa luftës Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutë me të cilën e ka cilësuar gjenocid atë që forcat serbe kanë zbatuar gjatë luftës në Kosovë. Tani sfida kryesore është hartimi i dosjes i cili do të duhej të dorëzohej në Gjykatën Ndërkombëtare me të cilën Serbia do të duhej të dënohej për krimin e gjenocidit. Ky është një mision jo aq i lehtë sepse kërkon punë e angazhim të përditshëm, por nuk është një mision i pamundur", ka thënë Asllani.

Libri i autorit Bardhyl Mahmuti është i bazuar në ngjarje të vërteta dhe është botuar në shënim të ditës së gjenocidit në Kosovë, më 15 janar 2021.

Promovimi i tij ka filluar tani sepse ishte shtyrë për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid-19. Pas Prishtinës, autori do ta përurojë librin edhe në Shkup, më 18 maj 2022, në hapësirat e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve.



Raportime kërcënuese për bomba në urat e Beogradit

Beograd, 16 maj - Pas raportimeve kërcënuese për bomba të vendosura në shkollat fillore të Beogradit, pasditen e 16 majit arritën kërcënime të reja se ishin vendosur bomba në urat në Beograd, si dhe në qendrën tregtare "Stadiumi" (Stadion), konfirmoi Ministria e Punëve të Brendshme për Radio Televizionin e Serbisë (RTS).

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë tha se Ura e Brankos, Ura e Gazelës, Ura e re hekurudhore, si dhe Ura e Pançevës janë ndër lokacionet ku janë marrë raportimet për bomba.

Raportimi për bombë ka arritur edhe në qendrën tregtare "Stadiumi" në Beograd, ku në orën 16:30 është caktuar ndeshja mes KF Vozhdovcit dhe KF Partizanit, transmeton RTS-ja.

Raportimet për bombat e vendosura kanë arritur, në mëngjesin e 16 majit, në 97 shkolla fillore dhe të mesme të Beogradit, ndërkaq pas verifikimeve në një numër të madh shkollash është konstatuar se njoftimet ishin të rreme, njoftoi Ministria e Arsimit e Serbisë.

Nxënësit janë kthyer në mësime, ndërsa në shkollat ku ende vazhdon inspektimi i sigurisë, nxënësit janë dërguar në shtëpi, thuhet në komunikatën e ministrisë. "Deri në orën 14:00 policia ka inspektuar 60 shkolla fillore dhe 13 të mesme në Beograd dhe është konstatuar se bëhet fjalë për shqetësim të rrejshëm, ndërkohë që të tjerat janë duke u inspektuar", ka deklaruar Sllavko Gak, sekretar për arsim dhe mbrojtje të fëmijëve, në një deklaratë të publikuar në faqen e internetit të qytetit të Beogradit.

Siç theksoi ai, nuk ka relaksim derisa të inspektohet edhe shkolla e fundit. "Siguria është gjëja më e rëndësishme në situata si kjo", tha Gak.

Raportimet kanë arritur, ndër të tjera, në shkollat fillore "Mbreti Pjetër i Dytë Karagjorgjeviq", "Vladimir Rolloviq", "Gjura Jakshiq", "Danillo Kish", "Shën Sava" dhe "Drinka Pavlloviq", transmeton RTS-ja. Sipas RTS-së, prindërit kanë marrë mesazhe që të mos i sjellin fëmijët në shkollë, mësimi nuk ka filluar dhe fëmijët që tashmë kishin arritur në shkolla, po kthehen në shtëpi. Po ashtu, policia e Nishit në mëngjesin e 16 majit ka marrë njoftim se në aeroportin "Konstantini i Madh" në atë qytet ishte vendosur një bombë.

Policia konfirmoi për agjencinë "Beta" se një kontroll kundërdiversant është duke u zhvilluar dhe se raportimi ka shumë të ngjarë të jetë i rremë.

Ky është raportimi i dytë për bombë të vendosur në Nish brenda një muaji, ndërkaq që ka pasur raportime të rreme për bomba të vendosura edhe në qendrat tregtare të këtij qyteti.

Dy raportime të rreme, se mjete shpërthyese ishin vendosur në stacionin hekurudhor të Beogradit të Ri dhe në kopshtin zoologjik të Beogradit, u dërguan gjithashtu më 15 maj.

Një raportim, në vargun e raportimeve të rreme, ishte të premten, më 13 maj, kur kërcënimet për bombë u dërguan në adresat e tri qendrave tregtare dhe katër konvikteve studentore në Beograd.

Në muajt e fundit, që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës, objektet publike në Beograd kanë qenë cak i raportimeve të rreme për bomba.

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë më herët kishte njoftuar se për shkak të raportimeve për bomba do të kërkojë ndihmë përmes bashkëpunimit policor operacional ndërkombëtar për të marrë informacione për urdhërdhënësin, organizatorët dhe zbatuesit e këtij krimi.

Deri më tani autoritetet në Serbi nuk kanë bërë me dije se kush është përgjegjës për këto raportime të rreme.

Është thënë se kërcënimet për bombat e dyshuara të vendosura vinin nga jashtë, me e-mail, nga një shërbim i koduar, i cili, ndryshe nga shërbyesit e tjerë, nuk ruan të dhëna.

Përkeqësohen parashikimet për ekonominë maqedonase

Shkup, 16 maj - Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovaçevski, tha se shtetin e tij po e pret një prej dimrave më të vështirë "me të cilin duhet të përballemi", prandaj ai shtoi se në rend dite nuk duhet të jetë kërkesa e opozitës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Opozita maqedonase ka kërkuar që të mbahet një takim i liderëve për ta caktuar datën për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Kovaçevski deklaroi më 16 maj se lufta në Ukrainë dhe kriza ekonomike që ka përfshirë botën po reflektohet në masë të madhe edhe në Maqedoninë e Veriut. "Qeveria po punon për t'i parandaluar goditjet e çmimeve dhe për të siguruar burime të energjisë për amvisëritë dhe industrinë. Jemi duke rishikuar buxhetin e shtetit dhe Ministria e Financave po ul kostot që nuk duhen bërë, të ketë fonde për t'i mbështetur kompanitë dhe kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve. Kuvendi është një vend ku ka komisione për të gjitha fushat, ku të gjitha zgjidhjet mund të diskutohen në mënyrën më demokratike. Parlamenti është, gjithashtu, një vend ku duhet të ushqehet demokracia, jo të bojkotohet", tha Kovaçevski.

Ndërkohë, Banka Popullore të hënën ka dalë me projektime të reja lidhur me politikat makroekonomike që parashikojnë një inflacion mesatar prej 8.8-përqindësh në vitin 2022, në rast të stabilizimit gradual të gjendjes ekonomike deri në fund të vitit.

Rritja ekonomike për këtë vit nuk do të jetë më e lartë se 2.9 për qind apo shifër më e ulët se projektimet e mëparshme që parashikonin rritje mbi 3.5 për qind. "Shoku pandemik, kriza energjetike, si dhe lufta në Ukrainë në tremujorin e parë të këtij viti, bartin rreziqe të mëtejshme për ekonominë maqedonase, e cila, para së gjithash, për shkak të ushqimit dhe energjisë, është e varur nga lëvizjet globale", deklaroi guvernatorja e Bankës Popullore, Anita Angelovska-Bezhoska.

Angelovska-Bezhoska tha se Banka Popullore pret që borxhi publik në periudhën afatmesme të arrijë në 63 për qind të Prodhimit Bruto Vendor.

Për t'u përballur me krizën, Ministria e Financave ka paralajmëruar marrjen e mbi 900 milionë eurove borxh, një pjesë përmes shitjes së eurobondit dhe tjetrën nga bankat e huaja.

Komisioni Rregullator për Energjetikë të hënën ka nisur konsultimet me kompanitë energjetike lidhur me çmimin e energjisë elektrike dhe pas dy javësh pritet të dalë me çmimin e ri. Nuk dihet ende se sa mund të jetë rritja e çmimit, ndërkohë që rritja e çmimeve të karburanteve vazhdon të caktohet në bazë ditore varësisht çmimit në bursat botërore.

Opozita: Projektligji për mjetet e Trustit, sa më shpejt në Kuvend

Albulena MAVRAJ

Prishtinë, 16 maj - Dy partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës që sa më shpejt të sjellë në Kuvend projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale. Ky projektligj do t'u mundësonte qytetarëve tërheqjen deri në 30 për qind të kursimeve pensionale.

Subjekti më i madh opozitar, PDK-ja, ka propozuar tërheqjen e mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale, që ndryshe njihet edhe si Trusti.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ka thënë se kanë pritur se gjatë kësaj mbledhjeje të miratohet ky projektligj. "Por, projektligji ende qenka në Komisionin për Buxhet dhe Transfere dhe ne kërkojmë nga ky komision që të reagojë sa më shpejt dhe ta sjellë projektligjin në mënyrë që ne si kryesi ta procedojmë për seancën e radhës. Pra, për këtë të enjte nuk do të jetë e mundur ta trajtojmë këtë. Por, besoj se të hënën e ardhshme [23 maj], kur do jetë mbledhja e radhës e kryesisë, do të kemi të gatshëm projektligjin dhe do ta kemi mundësinë që ta procedojmë në seancën e radhës", ka thënë Tahiri.

Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka kërkuar që ky projektligj sa më shpejt të vijë në Kuvend. "Silleni sa më shpjet projektligjin në Kuvend për shkak se tashmë edhe deputetët e shumicës e dinë se sa e rëndësishme është që të punësuarit që kanë paratë e tyre në Trust, t'i tërheqin ato në këtë krizë të madhe", ka theksuar ai.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Bekim Haxhiu, si iniciator i këtij projektligji, beson se ka vota të mjaftueshme, përfshirë edhe të deputetëve të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, që të miratohet tërheqja e kursimeve nga Trusti.

Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, më herët është shprehur kundër një propozimi të tillë. Por, Bekim Haxhiu ka thënë se ka biseduar me shumicën e deputetëve të Kuvendit, përfshirë ata të pushtetit dhe opozitës dhe se ata, sipas tij, kanë konfirmuar gatishmërinë për të votuar. "Ky projektligj është kërkesë e qytetarëve dhe nuk do të duhej të kishte dallime mes pushtetit dhe opozitës për realizimin e kërkesës së qytetarëve. Kam biseduar me shumicën e deputetëve në pushtet dhe në opozitë. Ata kanë pohuar se do të mbështetin këtë iniciativë qytetare. Në anën tjetër, ka një lloj presioni nga mazhoranca. Nuk e di arsyen", ka thënë Haxhiu.

Një ligj konsiderohet i miratuar nëse për të votojnë shumica e deputetëve të pranishëm në seancë. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. Për miratimin e të këtij projektligji është shprehur edhe partia tjetër opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës.

Haxhiu ka theksuar se deputetët nuk duhet të hezitojnë për miratimin e këtij projektligji për shkak se, sipas tij, ai do ta lehtësonte situatën financiare të qytetarëve pas shtrenjtimit të artikujve bazë.

Inflacioni në muajin prill të këtij viti ka arritur në rreth 11 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Ky projektligj gjendet në Komisionin për Buxhet dhe Transfere dhe pritet t'i dërgohet kryesisë së Kuvendit për futje në rend dite për shqyrtim.

Sipas propozimit të PDK-së, kontributpaguesit që kanë më pak se 10 mijë euro kursime pensionale kërkohet që të kenë të drejtën e tërheqjes së 30 për qind të mjeteve. Ata që kanë deri 20 mijë euro - 25 për qind, nga 20 mijë deri 30 mijë - 20 për qind. Për kontributpaguesit që kanë kursime pensionale në shumën prej 30 mijë eurosh - 15 për qind dhe ata mbi 40 mijë euro - 10 për qind të shumës.

Një tërheqje e ngjashme deri në 10 për qind është bërë në vitin 2020, pas përkeqësimit të gjendjes financiare të familjeve, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi.

Theksohet nevoja për plotësimin e vendeve me prokurorë të rinj

Prishtinë, 16 maj (ER) - Ushtruesi i detyrës i kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka mbajtur takimin e kolegjiumit me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive themelore, kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale si dhe kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit, ku të pranishëm ishin edhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të cilët monitorojnë prokuroritë përkatëse.

Në fillim të takimit, kryeprokurori Kelmendi u interesua për gjendjen në secilën prokurori, me ç'rast u njoftua për së afërmi nga kryeprokurorët për numrin e prokurorëve në prokuroritë që ata i drejtojnë, për rezultatet, të arriturat, sfidat dhe çështjet e tjera me rëndësi.

Gjatë diskutimeve të përbashkëta u theksua nevoja për plotësimin e vendeve të përcaktuara me prokurorë të rinj si dhe rekrutimi i stafit mbështetës në mënyrë që të avancohet efikasiteti dhe efektiviteti në trajtimin e lëndëve penale në secilën prokurori. Po ashtu, pjesë thelbësore e këtij takimi ishte diskutimi lidhur me rritjen e efikasitetit dhe zbatimin sa më unik të praktikave gjatë trajtimit të regjistrave penalë, përkatësisht lëndëve penale me PP, PPN dhe PPP nga ana e prokurorëve, dhe trajtimi sipas afateve ligjore i ankesave të qytetarëve për rastet disiplinore ndaj prokurorëve.

Në fund të takimit, u. d. kryeprokurori i shtetit, Besim Kelmendi, u ka ofruar bashkëpunim të ngushtë të gjithë kryeprokurorëve për adresimin dhe tejkalimin e të gjitha sfidave institucionale.

Kuvendi mban seancë të enjten

Prishtinë, 16 maj - Kryesia e Kuvendit e Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, kryesuar nga kryetari Glauk Konjufca. Në këtë mbledhje, në të cilën ishin të pranishëm edhe kryetarët e grupeve parlamentare, u vendos që seanca e re plenare të mbahet të enjten, më 19 maj, me fillim nga ora 10:00, me këtë rend të ditës: deklarimet jashtë rendit të ditës, pyetjet parlamentare, miratimi i procesverbalit nga seanca plenare e mëparshme, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Turizmin, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-113 për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-133 për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Pika për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit është shtyrë për një nga seancat e radhës. Pas përfundimit të punimeve të kësaj seance, të enjten, më 19 maj, do të vijohet me punimet e seancës së papërfunduar të datës 14 prill, përkatësisht me debatin parlamentar për sigurinë në vend. Në këtë mbledhje kryetarët e grupeve parlamentare u pajtuan që në mbledhjen e radhës të kryesisë t'i propozojnë emrat e anëtarëve për Komisionin Ad-hoc për reformën zgjedhore, të cilët më pas do të votohen në seancë.

Bislimi: Kurti, kryeministri i parë që po bën përpjekje për të ndërtuar ura bashkëpunimi me sektorin privat në ShBA

Prishtinë, 16 maj (ER)- Qeveria e Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës e cila është drejtuar nga zëvendës-kryeministri i parë, Besnik Bislimi. Ai ka folur fillimisht për vizitën e kryeministrit Albin Kurti në ShBA, duke e vlerësuar si të suksesshme. "Gjatë kësaj jave dhe asaj që lamë pas, kryeministri Kurti është duke zhvilluar takime shumë të rëndësishme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me zyrtarë shtetërorë, udhëheqës të ndërmarrjeve me renome ndërkombëtare, përfaqësues të organizatave, si dhe me komunitetin shqiptaro-amerikan. Një vizitë e kësaj natyre shkon përtej partneritetit politik, që e kemi gëzuar Kosova dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndër vite, duke i dhënë asaj të paktën edhe tri dimensione të tjera. Së pari është mundësia e bashkëpunimit në rrafshin e investimeve të huaja direkte e të punësimit në vend. Meqë Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbëjnë ekonominë më të madhe në botë, Kosova duhet t'i trajtojë me përkushtim mundësitë e bashkëpunimit me kompani amerikane, që të sjellim investime dhe vende të punës në Kosovë. Në këtë kontekst, kryeministri Kurti është kryeministri i parë që po bën përpjekje serioze për të ndërtuar ura bashkëpunimi me sektorin privat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka deklaruar Bislimi, duke shtuar se, së dyti, duke marrë parasysh se kompanitë amerikane janë inovatorët kryesorë në fushën e teknologjisë informatike dhe duke marrë parasysh potencialin që Kosova e tregon në këtë fushë, mundësitë janë reale, që të sjellim në Kosovë njohuritë më të reja në fushën e teknologjisë informative dhe ta bëjmë ndërlidhjen me tregun e ShBA-së dhe të vendeve të tjera ku operojnë këto kompani. "Së treti, diaspora e Kosovës në ShBA është një nga më të mëdhatë dhe më të suksesshmet, e cila ka luajtur rol qendror në çlirimin e vendit dhe vazhdon të kontribuojë në vend me gjithë mundësitë që i ofrohen. Potenciali i vajzave dhe djemve tanë në ShBA është i

jashtëzakonshëm. Qëllimi ynë është ta vëmë këtë potencial në shërbim të ndërtimit të një të ardhme prosperuese për qytetarët e Republikës së Kosovës", ka thënë ai.

Bsilimi para kabinetit qeveritar ka folur edhe për aplikimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. "Në anën tjetër, gjatë javës që lamë pas, Kosova, po ashtu, ka bërë një hap të rëndësishëm përpara me rastin e dorëzimit të aplikimit në Këshillin e Evropës nga zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme, znj. Gërvalla. Këshilli i Evropës është organizata më e vjetër ndërqeveritare në Evropë, që për qëllim kryesor ka sigurimin e bashkëpunimit dhe unitetit ndërmjet anëtarëve të saj në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit", është shprehur zëvendëskryeministri Bislimi.

Ai ka shtuar se pas anëtarësimit në KE, qytetarët tanë do të kenë edhe një instancë evropiane për t'i adresuar çështjet e tyre. "E kjo do të jetë në të mirë të tyre dhe drejtpërdrejt do të kenë ndikim në funksionimin e gjyqësorit në vend. Dorëzimi i aplikacionit ka qenë hapi i parë në një momentum shumë pozitiv dhe të koordinuar me miqtë dhe partnerët e Kosovës", ka thënë Bislimi.

Programi ACCESS lehtëson transformimin digjital në sektorin privat dhe publik në Kosovë

Prishtinë, 16 maj (ER) - Të hënën është mbajtur ngjarja përmbyllëse e programit ACCESS, program ky i cili pati për qëllim ta lehtësojë zhvillimin dhe transformimin digjital në sektorin privat dhe publik në Kosovë.

Ky program ka ardhur si nevojë e adresimit të sfidave dhe faktorëve të cilët pengojnë qasjen në treg dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të tregut në Kosovë.

Përgjatë katër vjetëve, ACCESS ka kontribuar në forcimin e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të sektorit privat dhe në rritjen e të ardhurave të tyre nëpërmjet qasjes së lehtësuar në treg brenda dhe jashtë vendit.

ACCESS ka lehtësuar transformimin digjital të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) përmes Iniciativës për Fuqizim Digjital, ka mundësuar krijimin e shërbimeve digjitale për bizneset fillestare dhe NVM-të përmes krijimit të Shërbimit Themelues në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ka krijuar lidhje tregtare mes ndërmarrësve vendorë dhe të huaj.

Po ky program ka rritur efikasitetin e bizneseve përmes krijimit të bazës ligjore për shërbimet elektronike të identifikimit, vërtetimit dhe besimit (e-iDAS); ka transpozuar ligjin dhe aktet nënligjore të Direktivës së BE-së për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit (NIS) dhe ka hartuar studimin e fizibilitetit për digjitalizimin e Postës së Kosovës.

Përmes kësaj ACCESS ka kontribuar në fuqizimin e e-tregtisë, e-qeverisjes dhe sigurisë kibernetike. ACCESS ka lehtësuar edhe ndërkombëtarizimin e NVM-ve të Kosovës përmes aktiviteteve të promovimit të eksportit dhe ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të konsulencës nëpërmjet certifikimit të konsulentëve vendorë dhe akreditimit ndërkombëtar të shoqatës së tyre (BCC) për të ofruar certifikime për transformim digjital.

Të pranishmëve u është drejtuar edhe ambasadori i Republikës së Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger, dhe Martin Engelberg, deputet i Parlamentit të Republikës së Austrisë, përgjegjës për Bashkëpunimin Zhvillimor Austriak, si dhe zëvendësministri i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Getoar Mjeku. "Derisa Republika e Kosovës shikon drejt një të ardhmeje me rritje dhe përfshirje më të madhe ekonomike, Republika e Austrisë do të vazhdojë të bëjë hapa të rëndësishëm jo vetëm në promovimin e transformimit digjital të sektorit publik dhe privat të Kosovës, por edhe në përmirësimin e infrastrukturës së saj digjitale dhe fizike", ka thënë ambasadori i Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger.

Nga Ministria e Ekonomisë u tha që transformimi digjital përfshin shumë më shumë se integrimin e teknologjive digjitale. Dhe pikërisht aktivitetet e projektit ACCESS kanë ndihmuar në transformimin e mënyrës së të menduarit te ne në atë mënyrë që ta konsiderojmë përdorimin e mjeteve dhe shkathtësive digjitale si mundësi dhe vlerë të shtuar për krijimin e përparësive krahasuese për ekonominë tonë. Zëvendësministri i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Getoar Mjeku, ka thënë që digjitalizimi është shumë i rëndësishëm për qeverinë dhe është pikë ndërlidhëse për të gjitha ministritë. "Në programin tonë digjitalizimi zë vend të rëndësishëm dhe ndërthurë sektorin publik dhe privat. Ne në agjendë kemi disa projektligje të rëndësishme që digjitalizimin e kanë për qëllim, për proceset e qëndrueshme të zhvillimit të vendit", ka theksuar ai.

KEDS-i filloi programin "Vajzat në teknologji - Girls TECH"

Prishtinë, 16 maj (ER) - Në ceremoninë e nëntëvjetorit të operimeve, KEDS ka lansuar projektin Girl TECH, që ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në fushën e teknologjisë informative. Vajzat e përzgjedhura nga shkollat e mesme profesionale të profilit të informatikës dhe gjimnazet e klasave të 12-ta zyrtarisht nisën një rrugëtim të ri, që KEDS-i e ka dizajnuar në kuadër të KEDS Academy, si një nga projektet më të rëndësishme në sektorin e arsimit në Kosovë.

Pas përfundimit të programit, për pjesëmarrëset të cilat arrijnë nivelet më të larta të avancimit profesional, do të jenë dyert e hapura edhe për punësim në kompani.

Ngacmimi i "ariut" të plagosur: Ç'do të ndodhë kur Suedia dhe Finlanda të anëtarësohen në NATO?

Nga Ivor ROBERTS
"The New European"

Në fillim të Luftës së Ftohtë, diplomati i shquar amerikan George Kennan analizoi shumësaktë motivet dhe perspektivën politike që kishin sovjetikët. Kennan tha se ato ishin një kombinim i ideologjisë komuniste, pasigurisë tradicionale ruse, dhe i ekspansionizmit carist.

Vladimir Putin e ka trashëguar plotësisht atë mendësi dhe qasje. Besimi i tij ideologjik se shpërbërja e Bashkimit Sovjetik ishte katastrofa më e madhe gjeopolitike e shekullit të kaluar, paranoja e tij ndaj kërcënimit që përbën Perëndimi për Russkit Mir (koncepti i "Botës Ruse", që është shndërruar në bazën e një kryqëzate kundër kulturës liberale të Perëndimit),dhe dëshira për ta shtrirë Rusinë afër shumicës së kufijve të dikurshëm të Evropës Perëndimore me Bashkimin Sovjetik, ilustrojnë se si Putin është një pasardhës i vërtetë i ideologëve sovjetikë si Stalini dhe Brezhnev.

Paranoja rritet nga besimi i tij se Perëndimi e shkeli premtimin e bërë dikur, për të mos e zgjeruar NATO-n në lindje. Sipas Rusisë, në vitin 1990 Sekretari amerikan i Shtetit, JamesBaker i dha garanci Mikhail Gorbachev se nuk do të kishte zgjerim të NATO-s përtej kufirit lindor të Gjermanisë, me kushtin që Rusia të pranonte ribashkimin e Gjermanisë.

Por sipas versionit amerikan të asaj bisede, Baker e pyeti Gorbachev se mos ndoshta donte tëlejonte një Gjermani të bashkuar, me kushtin që NATO-s të mos zgjerohej as edhe një centimetër. Po sipas versionit amerikan, lideri sovjetik u përgjigj se ai do të preferonte një Gjermani të pavarur të bashkuar jashtë NATO-s.

Nëse Baker do ta kishte dhënë një garanci të tillë, ai do të ishte përballur me parimin themeltar të NATO-s, që është mbajtja e derës hapur për anëtarët e rinj. Kur ajo që ata mendonin se dëgjuan rezultoi të ishte e gabuar, Putin dhe njerëzit e tij pretenduan se ishin gënjyer 2 herë nga SHBA-ja, pikërisht në kohën kur ata prisnin të ishin partnerë të barabartë në një rend të ri të sigurisë evropiane.

Sipas narratives ruse, zgjerimi i NATO-s, i udhëhequr nga George Bush (I Vjetri) dhe BillClinton, e dobësoi demokracinë e brishtë e të sapolindur të Rusisë, pikërisht në momentin kur ajo kishte më shumë nevojë për mbështetje. Kjo e nxiti Kennan të paralajmëronte se zgjerimi i NATO-s, do të ishte gabimi më fatal i politikës amerikane gjatë gjithë periudhës së pasLuftës së Ftohtë.

Mjerisht, në vend se Yeltsin të pasohej në detyrë nga një "Volodymyr Zelensky" rus, nga hiri i Bashkimit Sovjetik doli aparatçiku më i lig që kishte trajnuar ndonjëherë KGB-ja. Pra udhëheqësi më i keq i mundshëm që mund të ngjitej në krye në Rusi në ato rrethana.

Putini e ka parë me zemërim zgjerimin e NATO-s nga 16 vende në vitin 1991, në 30 vende sot. Rusia ka sot me NATO-n ka një kufi të drejtpërdrejtë prej 1215 km. Por, nga këndvështrimi i një Putin paranojak, situata do të përkeqësohet më tej.

Suedia dhe Finlanda, që të dyja shumë të alarmuara nga sulmi rus në Ukrainë, janë gati të kërkojnë anëtarësimin në NATO, teksa që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore preferuan një qasje neutrale. Nëse do të ndodhë kjo, NATO do të kishte në gjirin e saj 32 vende, dhe kufiri i Rusisë me NATO-n do të dyfishohej në 2.555 km.

Si Finlanda ashtu edhe Suedia, kanë ndjekur prej kohësh dhe për arsye të forta historike,politikën e mos-angazhimit në ndonjë aleancë ushtarake. Finlanda luftoi kundër një pushtimisovjetik në Luftën e Dimrit të viteve 1939-1940, dhe humbi rreth 10 për qind të territorit të saj.

Suedia e ruajti neutralitetin e vetme midis vendeve nordike gjatë Luftës së Dytë Botërore, nëdallim nga Danimarka dhe Norvegjia, pasi Hitleri e konsideronte territorin suedez si jo tënevojshëm për synimet e tij ushtarake. Pas luftës, Suedia iu bashkua qasjes së Finlandës,duke refuzuar t'i bashkohej NATO-s sikurse bënë Norvegjia dhe Danimarka.

Por me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, Suedia dhe Finlanda e ndjenë se duhej të braktisnin neutraliteti politik, ndaj aplikuan dhe u anëtarësuan në BE në vitin 1995. Ndonëse që nga fundi i Luftës së Ftohtë, Suedia dhe Finlanda kishin zhvilluar një bashkëpunim ushtarak tëngushtë me NATO-n, nuk e panë të nevojshme të ndryshonin statusin e tyre ushtarak, në atë të anëtarit të NATO-s.

Por sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës, e ka ndryshuar me vendosmëri opinionit publik në Suedi dhe Finlandë. Muajin e kaluar, mbështetja ndaj anëtarësimit arriti në 57 për qind në Suedi dhe 70 për qind në Finlandë. Partitë në të gjithë spektrin politik e mbrojnë tani anëtarësimin në NATO, dhe partitë qeverisëse socialdemokrate në të dyja vendet, janë gati ta parashtrojnë kërkesën në një referendum popullor.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka deklaruar se do të ketë një përgjigje pozitive dhe të shpejtë ndaj çdo kërkese të tillë, e cila mund të paraqitet në kohë për t'u shqyrtuar që në samitin e NATO-s, i cili do bahet në qershor në Madrid. Gjithsesi vendimi duhet të ratifikohet nga parlamentet e 30 anëtarëve aktualë të NATO-s.

Ndaj duket e pamundur që të dyja vendet të pranohen zyrtarisht dhe të gëzojnë mbrojtjen ngaNeni V (sulmi ndaj njërit është sulm ndaj të gjithëve) përpara vitit 2023. Ndërkohë, anëtarët e NATO-s do të duhet të përgatiten për të ofruar një parandalim të përkohshëm të besueshëm kundër një agresioni të mundshëm rus.

Rusia ka kërcënuar tashmë se do të vendosë armë bërthamore në enklavën e saj të Kaliningradit midis Lituanisë dhe Polonisë (edhe pse sipas Lituanisë, rusët kanë tashmë atje armë bërthamore). Por për të shmangur çdo justifikim për provokimet ose ndërhyrjet ruse, të dyja vendet ndoshta do të refuzojnë të vendosin sisteme raketore apo armë bërthamore në territorin e tyre.

Ndërsa rruga e Suedisë dhe Finlandës drejt anëtarësimit në NATO, duket të jetë relativisht e lehtë, edhe pse jo aq e shpejtë sa do të dëshironin disa, dy ish-republikat sovjetike, Moldavia dhe Gjeorgjia, që i prishur marrëdhëniet me Moskën, kanë pak shanse për të hyrë në aleancë.

Moldavia, ashtu si Ukraina, ka një rajon të shkëputur, Transnistrian, i banuar në shumicë ngarusisht-folësit, dhe që ndodhet që nga viti 1992 nën kontrollin e separatistëve të mbështetur nga rreth 1500 trupa ruse. Nga ana tjetër, neutraliteti i Moldavisë është i përfshirë në kushtetutën e saj.

Për më tepër niveli i lartë i korrupsionit dhe i çorganizimit të saj shtetëror, do të ngrinte pengesa të mëdha. Në vend të kësaj, ekziston rreziku që ajo të tërhiqet në luftën e Ukrainës. Për shpërthimet e fundit në rajon, Moska ka akuzuar Kievin, duke krijuar potencialisht një pretekst për ndërhyrje nga Rusia për të mbrojtur rusisht–folësit në Transnistria.

E njëjta skemë e Putinit që e kemi parë në Donbas. Në vitin 2008, NATO tha se Gjeorgjia mund të bëhej anëtare në të ardhmen, me kushtin që të vazhdonte përpjekjet për reforma.Edhe anëtarësimi i mundshëm i Ukrainës në NATO, do të mbetet pezull në pritje të rezultatit të luftës aktuale.

Presidenti Volodymyr Zelensky, ka pasur një qasje me pragmatike. Ai është tërhequr nga hyrja në NATO, por ka paraqitur një kërkesë zyrtare për anëtarësimin e vendit në BE. Shumë vende të BE-së e kanë kërkuar që Ukrainës t'i jepet statusi i vendit kandidatit, por të tjerët kanë përdorur një ton më të kujdesshëm.

Presidenti francez, Emmanuel Macron, është shprehur se nisja e procedurave të anëtarësimit me një vend në luftë janë të pamundura. Edhe kryeministri holandez, Mark Rutte, ka thënë se nuk mund të ketë një "procedurë të përshpejtuar". Shtetet e tjera anëtare janë të shqetësuara për korrupsionin dhe gjendjen e ekonomisë ukrainase.

Pra, duke pasur parasysh nevojën për unanimitet, përgjigja edhe një "po", por jo tani. Sigurisht, ndërsa anëtarësimi i Ukrainës në klubet perëndimore mbetet pezull, Zelensky ka probleme më urgjente me të cilat duhet të merret.

Marrë me shkurtime |
Shënim: Ivor Roberts, diplomat britanik në pension.



Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ministri Çeku: Punimet në stadiumin 'Adem Jashari' dhe atë të Gjilanit i kemi vënë në prioritet

Prishtinë, 16 maj - Punimet në stadiumin e futbollit "Adem Jashari" në Mitrovicë vazhdojnë të jenë shumë larg përfundimit pasi intensiteti i punës nga kompanitë përgjegjëse është shumë i ngadalësuar. Në lidhje me këtë çështje ka folur edhe ministri i Ministrisë së Sportit, Hajrullah Çeku, i cili ka thënë se kanë hasur në disa pengesa ligjore që po e pengojnë vazhdimin e punimeve në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë dhe se dinamika e zhvillimit të punimeve nuk është aspak e kënaqshme. "Në stadiumin 'Adem Jashari' në Mitrovicë kemi hasur në një pengesë ligjore, një çështje pronësore e cila na është prezantuar me vonesë dhe po trajtohet ai ngërç ligjor të cilin duhet patjetër ta tejkalomë për të vazhduar më tutje punime, ndërsa dinamika e punimeve për ne nuk është e kënaqshme. Ne po bëjmë gjithçka që të sigurohemi që ai stadium të përfundojë sa më parë", ka thënë Çeku.

Madje i pari i MKRS-së ka shtuar se probleme të ngjashme kanë edhe në stadiume të tjera si ai i Gjilanit dhe disa projekte të tjera infrastrukturore dhe se në këtë ka ndikuar shumë edhe rritja e çmimeve të materialit ndërtimor në Kosovës si pasojë e së cilës disa operatorë ekonomikë po refuzojnë t'i vazhdojnë punimet. "Jo vetëm stadiumi i Mitrovicës, edhe stadiume të tjera, edhe disa raste të infrastrukturës sportive në Kosovë, i kemi trashëguar me probleme shumë të mëdha dhe mbi këtë tani rëndon edhe fakti që shumë operatorë ekonomikë refuzojnë t'i vazhdojnë punimet për shkak të shtrenjtimit të çmimit të materialit ndërtimor në vendin tonë. Pra, janë edhe çështje procedurale, ligjore të cilat nuk janë trajtuar me kohë, tani duhet t'i zgjidhim të gjitha një nga një, por edhe kjo çështja e shtrenjtimit të materialit që po e bën të pamundur. Por, stadiumin e Gjilanit dhe stadiumin e Mitrovicës si investime kapitale me rëndësi shumë të madhe i kemi vënë në prioritet dhe po bëjmë gjithçka që është e mundur, mirëpo pengesat ligjore dhe procedurale nuk mund t'i tejkalojmë edhe aq lehtë", ka shtuar Çeku.

Edicioni i ri nis më 13 gusht

Prishtinë, 16 maj - Edicioni i ri i garave 2022/23 në futbollin e Kosovës do të nisë në fundjavën e dytë të muajit gusht. BKT Superliga garat do t'i fillojë më 13 gusht, derisa Liga e Parë më 20 gusht. Siç dihet, sivjet Kupa e Botës për herë të parë në histori të futbollit do të zhvillohet në periudhën 21 nëntor - 18 dhjetor, prandaj edhe kalendari i garave në të gjitha ligat do t'i përshtatet këtij formati. Ndërkohë, deri në përmbyllje të edicionit aktual kanë mbetur të zhvillohen ndeshjet e javës së 36 (të fundit) në BKT Superligë, barazhi i Ligës së Parë, barazhi për Superligë dhe finalja e Kupës së Kosovës.

Gjuka: Tash do të përgatitemi me garat ndërkombëtare

Pejë, 16 maj - Egzon Gjuka e ka udhëhequr Besa Famgasin drejt triumfit në Kupën e Kosovës. Ai u shpall lojtari më i mirë i finales e, po ashtu, i "Final Four". Në finalen ndaj Kastriotit, Gjuka i shënoi tetë gola. "Ia arritëm qëllimit që e patëm si skuadër, që ta fitojmë kampionatin dhe Kupën e Kosovës. Është viti i nëntë me radhë që shpallemi kampionë të Kosovës. Gjatë këtyre viteve tetë herë e kemi fituar Kupën e Kosovës. Kjo më së miri tregon seriozitetin, investimet dhe punën që bëhet në klubin Besa. Tani do t'i japim vetes pak pushim, pastaj do të fillojmë të përgatitemi për garat ndërkombëtare. Do të punojmë shumë që të kemi paraqitje sa më të mira", ka thënë Gjuka. Besa e ka përfunduar me trofe të Kupës edicionin në të cilin kishte vetëm fitore.

Ahmetxhekaj: Pasi të shijojmë trofetë, përgatitemi për ndeshjet evropiane

Istog, 16 maj - Blerta Ahmetxhekaj ishte pjesë e rëndësishme e Istogut në kampanjën që solli dy trofetë e hendbollit të Kosovës, atë të kampionit dhe Kupën. Portierja istogase ka pasur paraqitje të mira në Final Four të Kupës, që fundjavën e kaluar u zhvillua në Ferizaj. Istogu fillimisht kaloi Prishtinën e në finale e mposhti Ferizajn. "Arritëm ta mbyllim edicionin në mënyrën më të mirë ashtu si kemi pritur dhe kemi synuar që në fillim të edicionit - me të dy trofetë. Këtë edicion na karakterizoj angazhimi maksimal në secilën ndeshje. Pavarësisht prej lëndimeve me të cilat jemi përballur, i fituam të gjitha 28 ndeshjet. Tani do t'i shijojmë disa ditë trofetë, pastaj prioritet i kemi ndeshjet në Evropë për të cilat kemi synime të qarta", ka thënë Ahmetxhekaj.

Merlaku sërish e rrëmben çmimin 'ylli i javës'

Klinë, 16 maj - Kapiteni i skuadrës së Dukagjinit nga Klina, Atltin Merlaku, sërish e ka rrëmbyer çmimin "ylli i javës" që ndahet nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsorja e Superligës, Banka Kombëtare Tregtare. Merlaku pati një tjetër paraqitje të shkëlqyeshme në këtë edicion, duke qenë më i merituari për fitoren kundër Llapit, me rezultat 3-2. Altin Merlaku realizoi "hat-trick" në këtë takim, duke ia siguruar tri pikë shumë të vlefshme skuadrës së tij në luftën për t'i ikur barazhit. Kjo është hera e dytë në këtë edicion që Merlaku e fiton këtë çmim, pasi edhe në javën e 30 ishte shpallur më i miri. Një javë para përfundimit të kampionatit, KF Dukagjini (Klinë) ndodhet në pozitën e pestë me 49 pikë, dy më shumë se Malisheva, e cila ndodhet në pozitën e tetë që dërgon në barazh.

Eliminohen kampionët dhe skuadra më e mirë e sezonit të rregullt

Miami, 16 maj - Skuadra kampione e Milwaukee Bucksit ka dorëzuar titullin pas humbjes që pësoi në fushën e Bostonit me rezultatin 109-81. Bucksi u mendua se do të kualifikohej në finale pasi udhëhiqte 2-3 me ndeshje, por Celticsi përmbysi gjithçka në favorin e vet, duke fituar dy sfidat e fundit dhe krejt serinë 4-3. Ndeshja u dominua nga Bostoni, ku shkëlqyen Grant Williams me 27 pikë e Jayson Tatum me 23 pikë. Në finalet e "play-off" në Konferencën e Lindjes, skuadra e Celticsit do të përballet me Miamin, që ka faktorin fushë në favorin e saj. Në Perëndim vjen surpriza më e madhe, pasi eliminohet ekipi i Phoenix Sunsit, skuadra me rekordin më të mirë në sezonin e rregullt dhe që konsiderohej favoritja kryesore për titull. Suns u mposht me rezultat 123-90 në fushën e vet nga Dallas Mavericksi, që fitoi 4-3 serinë e gjysmëfinaleve. Ndeshje e dominuar nga Dallasi, ku u dalluan Luka Donqiqi me 35 pikë e 10 rebounde, Dinwiddie me 30 pikë e Brunson me 24 pikë, një treshe që udhëhoqi teksanët drejt suksesit. Ndeshje për t'u harruar për Phoenixin, ku mungoi lojtari lider dhe ku zhgënjyen të gjithë titullarët.

KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Miami - Philadelphia		(4-2)
Boston - Milwaukee	109-81	(4-3)

Konferenca e Lindjes - Finale "play-off"
Miami - Boston

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Phoenix - Dallas	90-123	(3-4)
Memphis - Golden State		(2-4)

Konferenca e Perëndimit - Finale "play-off"
Golden State - Dallas

Shumë lojtarë të Unitedit do të jenë pa kontratë

Manchester, 16 maj - E ardhmja e disa yjesh të Manchester Unitedit është në dyshim këtë verë. Ka pikëpyetje mbi gjashtë yje të skuadrës së parë, pesë perspektivë të akademisë dhe një yll aktualisht i huazuar, sipas "Manchester Evening News". Fituesi i Kupës së Botës të Francës, Paul Pogba, 29 vjeç, është pasuria më e madhe në një grup prej gjashtë yjesh të vjetër, të cilëve do t'u skadojë kontrata në qershor. Mesfushori i gjithanshëm është lidhur me lëvizjet te gjigantët evropianë, përfshirë Paris Saint-Germainin dhe Juventusin, dhe kampionët e Premierë Ligës, Manchester City.
Shokët e Pogbas, Nemanja Matiq, Jesse Lingard, Juan Mata dhe Edinson Cavani, së bashku me portierin rezervë Lee Grant, do të jenë gjithashtu agjentë të lirë. Legjenda e Uruguait me 54 gola, Cavani, raportohet se ka pasur shumë oferta dhe ka qenë i lidhur me klube duke përfshirë skuadrën e La Ligës, Real Sociedad.
Ish-ylli i Chelseat, Matiq, njoftoi në "Instagram" muajin e kaluar se po largohet nga "Old Trafford". Portieri Ondrej Mastny, 20 vjeç, mbrojtësi i majtë Reece Devine, 20 vjeç, mesfushorët Charlie Wellens, 19 vjeç dhe Connor Stanley, 20 vjeç, si dhe sulmuesi D'Mani Mellor, 21 vjeç dhe Mateo Mejia, 19 vjeç, janë jashtë kontratës.
I diplomuari i akademisë, Dylan Levitt, 21 vjeç, është gjithashtu në muajin e fundit të marrëveshjes së tij. Mesfushori i Uellsit me dhjetë ndeshje ka luajtur për ekipin e parë të Unitedit në një ndeshje të Ligës së Evropës kundër Astanës në vitin 2019. Ai ka impresionuar si i huazuar për skuadrën skoceze të ligës së lartë, Dundee United, këtë sezon dhe "Djajtë e Kuq" mund të realizojnë një opsion njëvjeçar për ta mbajtur atë.

SHKURT

Verstappeni: Dua ta mbroj titullin në Formula 1

Piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, është shprehur se ndihet i motivuar për ta mbrojtur titullin kampion në këtë duel ndaj Charles Leclerc me Ferrari. "Thashë se nëse fitoj një titull, atëherë objektiv imi në Formula 1 është i përmbushur dhe se gjithçka që do të vijë më pas do të jetë një bonus, që do ta shijoj. Nuk është sikur të thuash të fitosh një titull dhe tani të shkojmë të festojmë,
pasi nuk jam më i motivuar. Përkundrazi. Tani mendoj se motivimi është edhe më i madh, për t'u përpjekur që të përjetoj sërish atë emocion si vjet. Tani më pëlqen më shumë të shijoj edhe fundjavat pushim me familjen time, duke qenë larg garave", u shpreh Verstappeni.

Salahi dhe Van Dijku nuk mungojnë në finalen e Ligës së Kampionëve

Mohamed Salah dhe Virgil Van Dijk janë lënduar të shtunën, por lajm i mirë është se të dy futbollistët nuk mungojnë në finalen e Ligës së Kampionëve kundër Real Madridit. "Sigurisht që do të jem gati për finalen, gjithçka është në rregull", ka thënë Salah. Ndërsa mbrojtësi holandez ka konfirmuar se asgjë nuk ka për t'u shqetësuar lidhur me lëndimin e tij. "Ndjeva një kërcitje në gju pas 20 minutash pas një sprinti. Do të bëjmë kontrolle të tjera dhe shpresojmë të mos ketë probleme. U zëvendësova për të mos rrezikuar", ka thënë Van Dijku.

Mbappe: Kam vendosur ku do të luaj në të ardhmen

Kylian Mbappe nuk e ka zbuluar ende të ardhmen e tij, por ka siguruar se vendimin e ka marrë. "Nuk mund të flas për të ardhmen time, por do ta mësoni shumë shpejt… Është pothuajse e vendosur. Ky nuk është momenti i duhur, por po, po, vendimi është pothuajse i marrë. Zyrtarisht do ta publikoj vendimin për të ardhmen përpara se të bashkohem me kombëtaren e Francës në qershor. Ne duhet t'i respektojmë të gjitha palët e përfshira. Ka mbaruar, kanë mbetur vetëm pak detaje, por tani ka mbaruar", ka thënë Mbappe.

Jesusi, afër Arsenalit

Gabriel Jesus do të jetë i sakrifikuari i Manchester Cityt në verë pas transferimit të Erling Haalandit. E ardhmja e brazilianit me shumë mundësi do të jetë Arsenali. Sipas "football.london", "Topçinjtë" e kanë prioritet sulmuesin brazilian për ta rritur forcën sulmuese sezonin e ardhshëm, që mund ta shënojë rikthimin e tyre në Ligën e Kampionëve. Sipas Fabrizio Romanos, gazetar italian i specializuar për lëvizjet e futbollistëve, klubi londinez është duke finalizuar ofertën që do t'ia paraqesë Manchester Cityt për brazilianin, e cila do të jetë rreth 40 milionë euro.

Suarezi largohet nga Atletico, e dëshiron Interi

Interi ka kontaktuar me agjentin e Luis Suarezit për një transferim të mundshëm si lojtar i lirë në verë. Sulmuesi 35-vjeçar do të largohet nga Atletico Madridi në fund të muajit të ardhshëm pas dy vjetësh, duke e detyruar atë të gjejë një shtëpi të re këtë verë. Ai ka shënuar 11 gola në 33 paraqitje në La Liga këtë sezon, duke dëshmuar se ai ka ende nuhatje për golin. Siç raporton "Fichajes", Interi ka kërkuar informacione për Suarezin teksa përgatitet ta forcojë sulmin e tyre në afatin kalimtar të verës. Marrja e veteranit në një transferim të lirë do t'i jepte Simone Inzaghit një sulmues me përvojë për ta rritur cilësinë në fazën ofensive. Megjithatë, ka klube të tjera që janë të interesuara për ish-lojtarin e Liverpoolit dhe Barcelonës, si Aston Villa dhe Inter Miami. Suarezi dikur ishte afër një kalimi te Juventusi, por marrëveshja nuk u konkretizua kurrë për shkak të një situate të diskutueshme që përfshiu lojtarin në një falsifikim të testit të gjuhës italiane.

Awinita
Kompani Amerikane New York — Filijala Prishtinë

KOMPANIA AMERIKANE "AWINITA" ME SELI NË PRISHTINË, SHPALL

Konkurs për një vend pune: Asistente në zyre.

Kushtet që duhet të plotësoj kandidati janë: Njohja e gjuhës angleze, si dhe njohuri të mirë të kompjuterit.

Kandidatja duhet të ketë shkathtësi në komunikim.

Zyrat qendrore të kompanisë janë në Rrugën C në lagjen Mati 1 në Prishtinë.

Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 045-805-352.

CV- të dërgohet në këtë email adresë: e_zeni@hotmail.com

Intervistimi dhe vlerësimi bëhet në zyrat e kompanisë.

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

Njoftim për tatimpagues

Deklarimi elektronik i Librit të Blerjes dhe Librit të Shitjes

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë tatimpaguesit, të cilët janë deklarues të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar se janë të obliguar për të deklaruar Librin e Blerjes dhe Librin e Shitjes, përmes Sistemit Elektronik EDI.

Libri i Blerjes dhe Libri i Shitjes, duhet të deklarohen në baza mujore nga data 01 deri me 20 të muajit vijues, pra librat do të deklarohen në periudhën kur dorëzohet edhe Deklarata e TVSH-së.

Sa ju përket të dhënave, të cilat duhet të plotësohen në Librin e Blerjes dhe Librin të Shitjes, si dhe Udhëzuesit për plotësimin e tyre, referojuni mostrës së publikuar në ueb-faqen e ATK-së www.atk-ks.org te linku Shërbime Elektronike - Libri i Blerjes dhe i Shitjes http://www.atk-ks.org/librat-e-blerjes-dhe-te-shitjes/

Administrata Tatimore e Kosovës

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Martin Gjetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".

▶Lendita Llapqena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".

▶Muhamet Furra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

▶Agron Dinaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".

▶Bujar Vehapi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari.

▶Albert Bulliqi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të parë dhe të dytë të Gjimnazit "Gjin Gazulli" Prishtinë.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

THIRRJE PUBLIKE

TRAJNER PËR MBAJTJEN E TRAJNIMIT PËR SPITALIN E PËRGJITHSHËM TË GJILANIT DHE PRIZRENIT

Hyrje

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Përshkrim i shkurtër i qëllimit të projektit

Si pjesë e zbatimit të aktiviteteve të Marrëveshjes së Delegimit për Fonde dhe Zbatim (MDZF) ndërmjet Odës së Mjekëve të Kosovës dhe LuxDev, sipas Rezultatit 2, është paraparë zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit spitalor të Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, për t'i mundësuar stafit të këtyre spitaleve, të ofrojë shërbime cilësore për pacientët, bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira mjekësore. **Për këtë Oda e Mjekëve të Kosovës bën thirrje për Trajnerët të specializuar të cilët do të ofrojnë trajnime klinike që përfshijnë këto fusha për mjekët:**

- Shërbime për nënën dhe fëmijën
- Anesteziologji me kujdes intensiv
- Urologji
- Diagnostikim
- Sëmundje të brendshme

Objektivat e angazhimit dhe rezultatet e pritura

Objektivi i këtij angazhimi të trajnerëve është të sigurojë një program trajnimi për personelin mjekësor në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan dhe Prizren në fushat si në vijim:

- **Radiologji (Ultrazëri dhe Rezonanca Magnetike-RM)/Pediatri**
  - Ultratingulli për abdomen dhe pelvik
  - Ultratingulli i artikulacionit coxofemoral tek neonatët
  - Ultratingulli i zemrës
  - Ultratingulli i trurit
- **Ortopedi/Radiologji**
  - Ultratingulli i artikulacionit coxofemoral tek neonatët
  - Echo e abdomenit dhe e kërdhokulave
  - Ekzaminim osteomuskular me Ultrasound dhe Osteopati
- **Kardiologji e fëmijëve**
  - Ultratingulli i zemrës
- **Neurologji/Pediatri**
  - Ultratingulli i trurit (tek fëmijët)
  - EEG dhe Echo trurit
- **Kirurgji/Gjinekologji**
  - Hysterctomi Vaginale
  - Ultratingull morgologjik
- **Urologji/Radiologji**
  - Aplikimi i TOT - tape tek stres incintinenca
  - Aplikimi i nefrostomës perkutane
- **Ortopedi**
  - Blloqet Periferike
  - Artroskopi
- **Radiologji**
  - Punksioni i gjëndrës tiroide, dopleri i karotideve
  - Ultratingulli abdominal, Dopleri i enëve të gjakut
  - Ultratinguli Osteomuskular dhe Abdominal
  - Ultratingulli i sistemit osteomuskular
  - Dopler i karotideve
  - MRI
- **Gastroenterologji/Kirurgji**
  - Endoskopi e sipërme dhe e poshtme
  - Endoskopi gastroenterologjike
- **Kirurgji torakale/Pulmologji/Alergologji**
  - Bronkoskopi
  - Spirometri
- **Neurologji**
  - EEG
  - Sleep APNE
- **Anesteziologji dhe emergjencë**
  - Reanimim neonatal/Oksigjenoterapia te të porsalindurit
  - Vendosja e kateterit dhe transfuzioni te të porsalindurit
  - Anestezioni regjional
  - Anestezioni në obstetrikë
  - Mjekim intensiv
  - Menaxhimi i traumës në emergjencë
- **Kardiologji**
  - Kardiologji invazive (katederizmi i zemrës)
  - Echo transezofageal
- **Kirurgji**
  - Tumoret e Kolonit
  - Endoskopi intervente
- **Oftalmologji**
  - Operimi i kataraksit me FAKOEM
- **ORL**
  - Audiovestibullogji
  - Onkologji në ORL
  - Trauma në maksilë

Trajnimet priten t'u ofrojnë mjekëve aftësi për të ofruar shërbime të specializuara për pacientët dhe t'u mundësojë atyre që të njihen mirë dhe të jenë kompetentë në kuptimin, funksionimin dhe aplikimin e pajisjeve ekzistuese në punën e tyre të përditshme brenda departamenteve të tyre spitalore përkatëse. Trajnimet duhet të rrisin shkathtësitë e stafit të përzgjedhur për të punuar në departamente të specializuara, si dhe do të mundësojnë për të mësuar më shumë rreth cilësisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Metodologjia

Trajnerët e përzgjedhur do të punojnë ngushtë me stafin e departamenteve: Nëna dhe fëmija/Gjinekologji, Kirurgji, Anestezioni me ME, Neurologjisë, Radiologjisë dhe Kardiologjisë të SP-së Gjilan dhe Prizren dhe do të ofrojnë trajnime në formë të:

- Trajnim në punë
- Seminare/Punëtori
- Trajnim virtual
- Trajnim hibrid (virtual dhe fizik)

Pritshmëritë

Nën udhëzimin e përgjithshëm të OMK-së dhe të SP Gjilan dhe Prizren dhe në bashkëpunim me ekipin trajneri i angazhuar pritet të:

- Përgatit module të trajnimit
- Propozojë afatin kohor të sesioneve të trajnimit
- Vlerësojë proceset dhe protokollet ekzistuese në departamentet përkatëse brenda Spitalit të Përgjithshëm në Prizren dhe Gjilan
- Mbështet stafin për të përpunuar protokollet dhe udhëzimet e nevojshme
- Së bashku me trajnuesit, të përpilojë Procedura Standarde të Operimit
- Përgatit një raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve

Trajneri do të punojë drejtpërdrejt me mjekët e departamenteve të Shërbimit për nënën dhe fëmijën, Anesteziologji me kujdes intensiv, Urologji, Diagnostikim, Sëmundje të brendshme. Megjithatë, për të kryer me sukses detyrat e mësipërme, ai/ajo do të punojë ngushtë me ekipet e menaxhimit të Spitaleve dhe do të sigurojë raporte mujore që përmbledhin progresin dhe arritjet. Eksperti është i detyruar të përgatisë raporte mujore të progresit, të cilat do t'u dërgohen për miratim drejtorëve të SP-ve dhe Kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Kohëzgjatja

Fillimi: Qershor 2022

Koha e parashikuar e punës: 21 ditë brenda 3 muajve

Hapi	Përshkrimi i aktivitetit	Nr. ditëve	Vendi
1	Përgatit dhe prezanton përmbajtjen e moduleve të trajnimit	1	Vend i pacaktuar
2	Organizon dhe zbaton sesione trajnimi - në punë dhe sesione trajnimi on-line	15	Në një vend të caktuar
3	Kryen një vlerësim për të rishikuar proceset dhe protokollet ekzistuese në departamentin e radiologjisë	1	Vend i pacaktuar
4	Harton udhëzime dhe protokolle për përdorim	4	Vend i pacaktuar
	Total	21	

Kualifikimet dhe përvoja

- Diplomë universitare në Mjekësi
- Specializim dhe diplomë master në fushën përkatëse
- Leje pune dhe licencë nga institucionet përkatëse profesionale
- Minimumi 10 vjet përvojë në departamentet përkatëse të specializuara
- Certifikata nga trajnimet e vijuara në fushën përkatëse
- Aftësi të forta ndërpersonale
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit verbal dhe në të shkruar dhe përvojë e demonstruar në punën me ekipe të ndryshme
- Njohës i TI-së
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe angleze në të shkruar dhe në të folur

Dokumentet dhe procedura për aplikim:

- Kopja e diplomave
- Kopja e Certifikatës së Licencimit nga institucioni përgjegjës;
- Kopja e certifikatave
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të trajnimit përkatës dhe mbajtjen e trajnimeve;
- Një letër që përfshinë ekspertizën dhe përvojën në fushën e mbajtjes së trajnimeve në njërën nga fushat e kontratës (Shërbime për nënën dhe fëmijën, Anesteziologji me kujdes intensiv, Urologji, Diagnostikim, Sëmundje të brendshme)
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozim financiar

Propozimi financiar, Kërkesa financiare duhet të jetë e detajuar për secilën punë që do të realizohet, këtu duhet të përfshihet, mbajtja e trajnimeve, shkrimi i raporteve dhe një plan tentativë i punës;

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: **info@omk-rks.org** me subjektin Aplikacioni për Trajner/e për mbajtjen e trajnimit në SP Gjilan dhe Prizren apo edhe në mënyrë fizike në zyrat e Odës së Mjekëve të Kosovës, adresa QKUK, Instituti A, Kati III, 10000, Prishtinë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: 27 Maj 2022, ora 16:00. Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen.

ROYAL CROWN;
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0,5L

MËKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues